

VENDIM
Nr. 199, datë 3.8.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NRG POWER” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(Ndryshuar me vendimin nr. 165, datë 31.7.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1379/9 prot., datë 29.7.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘NRG Power’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 169, datë 28.6.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 29.6.2022 dhe 30.6.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.7.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Me shkresën nr. 674/3 prot., datë 7.7.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme dhe për dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 674/4 prot., datë 18.7.2022 dhe nr. 673/6 prot., datë 28.7.2022.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë gjithë dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria ka depozituar në ERE informacion mbi sistemin IT që do të instalojë për qëllime të ushtrimit të veprimtarisë, ndaj me fillimin e operimit, ajo të dokumentojë në ERE instalimin e këtij sistemi.

- Kontrata e qirasë e depozituar nga shoqëria në kuadër të dokumentacionit që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve, është e vlefshme deri më 31.12.2024 dhe nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, ndaj shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar, jo më vonë se data e fundit e afatit të vlefshmërisë së saj, pra brenda datës 31.12.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. *Shfuqizuar.*

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti